[Shqiptarja.com]

E hënë 25 Mars 2024 - Përditësimi i fundit 12:29

Kërko

LIVE [Shqiptarja.tv]

HOME EDICIONET LOKALE KRONIKË POLITIKË SHËNDETI EKONOMI SPORT KOSOVË & RAJONI BOTË KULTURË EDITORIAL OPINION

TË FUNDIT SOCIALE DREJT PUNËS SPECIALE LIFESTYLE VIP & SPEKTAKËL RECETA HOROSKOPI DOSJE FOTOGALERI VIDEOGALERI PIKË E ZEZË SONDAZHE

Flash Komisioni Hetimor për 2 koncesionet në Shëndetësi, Vokshi: Do thërrasim për të pyetur edhe Edi Ramën

POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

1 Tiranë- Durrës, një garë breshkash

2 Rrëfimi i mallit i Elton Birgënt: Babait i thashë se më pëlqenin mustakët që vë '91- shiri Më dha një kashillë shumë të vlefshme

3 Në Mal të Zi paralajmërojnë votë kundër pranimit të Kosovës në Këshillin e Evropës

4 LIVE- Komisioni Hetimor i Shëndetësisë nis me përpjekje mes kryetarit Vokshi e nënkryetarit Ndrecal Rithemelimi hoqi dorë nga heltimi i 2 koncesioneve të lidhura me Allgboun

5 Masakra në Moskë, 4 të arrestuarit dolën para gjykatës, me sy të njomë e vesh të prerë (VIDEO)

Kronikë

Bënin qitje me kallashnikov për t'i postuar në Tik-Tok, arrestohen 6 të rinj në Durrës! Në pranga dhe babai i njërit prej tyre

6 të rinj janë arrestuar dhe një tjetër është vënë në hetim, nga policia pasi janë kapur duke qëlluar me armë zjarri kallashnikov, në një kodër në fshatin Hamallaj. Po ashtu policia ka prangosur edhe babanë e një prej djemve, i cili kishte armën pa leje në banesë

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

GetButton

Redaksia
25 Mars, 12:11 | **Përditësimi: 25 Mars, 12:23**

Share

DURRËS- 6 të rinj janë arrestuar dhe një tjetër është vënë në hetim, nga policia pasi janë kapur duke qëlluar me armë zjarri kallashnikov, në një kodër në fshatin Hamallaj. Po ashtu policia ka prangosur edhe babanë e një prej djemve, i cili kishte armën pa leje në banesë.

Të rinjtë kryenin qitje me armë me qëllim postimin e videove në rrjetin social Tik-Tok.

Në kuadër të operacionit të koduar 'Qitësit', policia ka arrestuar Njazi Sulën 56 vjeç dhe djalin e tij, Mirlind Sula, 19 vjeç, të dy banues në fshatin Rrushkull, për veprën penale "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit".

LEXO EDHE:
Java e Shenjtë e katolikëve, kremtohet e Diela e Larit në Durrës, At Bernard Caruana: Fjala e Zotit na fton t'i kundërvihemi me guxim dhunës e gënjeshtrës

Gjatë operacionit u gjet arma e zjarrit kallashnikov me të cilën të rinjtë kryenin qitje. Policia gjeti dhe sekuestroi në banesën e tyre një armë zjarri pushkë dhe municion luftarak. Së bashku me armët, u sekuestruan 2 automjetet me të cilat lëviznin këta shtetas, si dhe 8 celularë.

Po ashtu ka arrestuar, Klivan Pepkolaj, 19-vjeç, Klajdi Jaku, 20 vjeç, Aurel Toshi, 18-vjeç, Andi Hajdarkolaj, 19 vjeç, dhe Eljos Toshi, 19 vjeç, të gjithë banues në Tiranë, për veprën penale "Moskallëzimi i krimit".

Në lidhje me arrestimin ka reaguar edhe ministri i Brendshëm, Taulant Balla.

> *'Armëmbajtja pa leje nga të rinjtë, ekspozimi i armëve në rrjete sociale, kërkojnë angazhim maksimal të Policisë së Shtetit, për evidentimin dhe goditjen e tyre. Përgëzime Policisë së Shtetit Durrës, e cila përmes monitorimit të rrjeteve sociale ka identifikuar shtatë persona në moshë të re si posedues armësh zjarri.'- shkruan Balla.*

M.Q./r.k./Shqiptarja.com

TAG: Durres hamallaj tik tok njazi sula mirlind sula

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
Arrestimi i Goros, a besoni se SPAK do bëjë drejtësi për pronat?

Po Jo Nuk e di

Lajme të tjera

Durrës/ Dhunoi me dorezë hekuri 2 punonjësit e pikës së karburantit, arrestohet 26-vjeçari
24 Mars, 12:31

Me kanabis në makinë gati për ta shitur, arrestohet 36-vjeçari në Durrës
24 Mars, 10:21

Durrës, sherr në një pikë karburanti, dy persona godasin punonjësin dhe përfundojnë në komisariat
23 Mars, 15:30

Përplasja me armë për një vajzë në Shijak, arrestohet "ish-i" përndjekës! Në kërkim shpallen 2 të tjerë
23 Mars, 11:57

Durrës, po tentonte të vidhte një automjet, arrestohet në flagrancë 28-vjeçari (EMRI)
23 Mars, 10:26

Durrës/ Aksidentohet për vdekje 20 vjeçari, u përplas sapo doli nga lokali, rruga pa trotuar! Shoqërohet shoferi, makina ishte me shpejtësi
22 Mars, 17:25

Shijak/ Qëllon drejt dyqanit, plumbat kapin punëtorin, shënjestra ishin pronarët e biznesit! Dyshohet konflikti për një vajzë (EMRAT)

Aldo Mustafa

22 Mars, 11:55

13 kg heroinë nga Durrësi drejt Italisë, dërgohen për gjykim pronari dhe shoferi i autobusit! Dosja dhe përgjimet
21 Mars, 16:47

Punësimet në ushtri, nis rekutrimi i të rinjve në Durrës! Koloneli: Paga të mira për ushtarët, po rritet interesi

Aldo Mustafa

21 Mars, 13:45

Durrës, arrestohet 30-vjeçari, iu gjetën 116 mijë € në makinë, dyshohet të ardhura nga krimi (EMRI+VIDEO)
21 Mars, 12:05

Siguria kibernetike, Tafa: Shqipërisë i mungojnë 170 ekspertë
20 Mars, 14:55

Vrasja e Gentian Bejtjas, arrestohet një prej autorëve! Në pranga edhe pronari i mjetit me të cilin u larguan ekzekutorët nga Fushë Kruja! Detaji që i zbuloi
20 Mars, 10:18

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje